



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet: 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, nenin 49 paragrafin 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr. 17, dt. 16 shtator 2011), duke u bazuar në nenin 8 paragrafin 1.4, shtojcën 6 dhe nenin 33.2 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, nxjerr:

#### **UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Për mundësinë dhe procedurat e realizimit të procesit të avancimit të nxënësve**

Numër: 14/2011

Datë: 30.12.2011

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të përcaktohen mundësitë, procedurat, kushtet, kriteret dhe mënyrat e realizimit të avancimit.

#### **Neni 2 Propozimi dhe shqyrtimi i propozimit**

1. Procedura për avancim të nxënësit fillon të realizohet me propozimin e:
  - 1.1. Mësuesit të klasës;
  - 1.2. Mësimdhënësit të lëndës;
  - 1.3. Kujdestarit të klasës;
  - 1.4. Këshillit të klasës;
  - 1.5. Aktivit profesional;
  - 1.6. Prindit.

2. Propozimin e shqyrton Këshilli i arsimtarëve, i cili sugjeron për vazhdimin ose ndërprerjen e procedurës për avancim, ndërsa drejtori është i obliguar të përgatisë raportin me shkrim me arsyetim për avancimin ose mos avancim.
3. Nxënësi i cili propozohet për avancim, vazhdon mësimin në klasën ekzistuese të vitit përkatës deri në mbarim të vitit shkollor.
4. Procedurat për avancim fillojnë në gjysmë vjetorin e dytë të vitit përkatës dhe përfundojnë me mbarimin e vitit shkollor.

### **Neni 3 E drejta për avancim**

1. Të drejtën për avancim e fitojnë :
  - 1.1. Nxënësit me njohuri të përgjithshme dhe me sukses të dalluar;
  - 1.2. Nxënësit me talent në ndonjë lëndë/fushë mësimore;
  - 1.3. Nxënësit me nevoja të veçanta.

### **Neni 4 Dokumentacioni**

1. **Për avancimin e nxënësve duhet përgatitur:**
  - 1.1. Propozimin me arsyetim me shkrim nga propozuesi;
  - 1.2. Raportin me shkrim nga Këshilli i arsimtarëve, i cili ka shqyrtuar propozimin;
  - 1.3. Rezultatit e testit të inteligjencës;
  - 1.4. Suksesin nga vitet e mëparshme të shkollimit;
  - 1.5. Dëshminë për talentin që e posedon nga lënda/fusha mësimore.

### **Neni 5 Llojet e avancimit**

1. Avancimi brenda arsimit fillor.
2. Avancimi prej arsimit fillor në arsimin e mesëm të ulët.
3. Avancimi brenda arsimit të mesëm të ulët.
4. Avancimi prej arsimit të mesëm të ulët në arsimin e mesëm të lartë.
5. Avancimi brenda arsimit të mesëm të lartë.
6. Avancimi prej arsimit të mesëm të lartë në arsimin e lartë.
7. Avancimi për nxënësit me njohuri të përgjithshme dhe me sukses të dalluar mund të bëhet vetëm brenda një niveli dhe mund të avancohet vetëm për një klasë.
8. Avancimi për nxënësit me talent në ndonjë lëndë/fushë mësimore mund të bëhet brenda një shkalle/niveli, prej një shkalle/niveli në shkallë/nivel tjetër dhe avancimi i tërë nivelit.

## **Neni 6**

### **Procedura paraprake për avancim të nxënësit**

1. Kërkesën dhe propozimin me dokumentacion të nevojshëm për avancim të nxënësit, drejtorja e shkollës ia paraqet Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) më së largu deri me 20 janar të vitit vijues.
2. Kërkesën për avancim të nxënësit, DKA e shqyrton më së largu deri më 10 shkurt të vitit vijues dhe lidhur me të nxjerr vendim për miratim ose mosmiratim të kërkesës për avancim. Nga një kopje e vendimit i dorëzohet drejtorisë së shkollës dhe nxënësit. Kërkesën e miratuar me dokumentacion përkatës e dorëzon në DVSM – MASHT/ kryetarit të komisionit për avancim të nxënësve më së largu deri më 1 mars të vitit vijues.
3. Pala e pakënaqur me vendimin e DKA-së mund t'i paraqesë ankesë Komisionit për ankesa të MASHT-it në afat prej 3 ditësh, prej ditës së pranimi të vendimit. Kryetari i komisionit të MASHT-it, lidhur me ankesën nxjerr vendim më së largu deri më 20 shkurt të vitit vijues.
4. Komisioni për avancimin e nxënësve përgatit listën e nxënësve që duhet të përfshihen në testin për avancim më së largu deri më 10 mars të vitit vijues. Lista miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT .

## **Neni 7**

### **Testi i inteligjencës**

Para se të bëhet procesi i vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive, nxënësi duhet t'i nënshtrohet testimit para komisionit për matjen e inteligjencës, në institucionet shtetërore profesionale të Fakultetit të Mjekësisë.

## **Neni 8**

### **Njoftimi i nxënësit për fitimin e së drejtës për të hyrë në testin për avancim**

1. DVSM, më së largu deri me 20 prill të vitit vijues, e njofton nxënësin dhe drejtorinë e shkollës për të drejtën e hyrjes në testin për avancim.
2. Testimin për avancim e organizon DVSM – MASHT.
3. Testimi organizohet prej datës 5 maj deri më 31 gusht të vitit vijues.
4. Për datën dhe vendin e testimit për avancim, nxënësi njoftohet nga kryetari i komisionit (Divizioni për Vlerësime, Standarde dhe Monitorim në MASHT).

## **Neni 9**

### **Testi për avancim**

1. Testin për avancim të nxënësve e përpilon Sektori i Vlerësimeve në MASHT, apo e koordinon procesin e vlerësimit edhe me komisionin vlerësues, po të atij niveli në të cilin kërkon të avancohet nxënësi.



2. Testi për avancim bazohet në rezultatet mësimore për lëndën/fushën mësimore të kurrikulit, sipas shkallës/nivelit arsimor të cilin nxënësi kërkon ta kryejë nëpërmes avancimit.
3. Nxënësi me talent të veçantë vlerësohet sipas kompetencave të kurrikulit për klasë/shkallë/nivel.
4. Testi për avancim përmban kërkesa (pyetje) të hapura dhe të mbyllura.
  - 4.1. Kërkesat (pyetjet) i përpilon komisioni vlerësues për lëndën apo fushën e caktuar lëndore.
  - 4.2. Për kërkesat (pyetjet) e hapura duhet përgatitur skema e qortimit, për të cilën nxënësi duhet të arsyetohet për numrin e pikëve të fituara.
  - 4.3. Për kërkesat (pyetjet) e tipit të mbyllur duhet përgatitur çelësi.
5. Përqindja e kërkesave (pyetjeve) në testin për avancim për lëndën/fushën mësimore, përcaktohet në kurrikul.

#### **Neni 10** **Vlerësimi i nxënësit**

1. Nxënësi mund të vlerësohet në mënyrë të kombinuar, me shkrim dhe me gojë. Ndërsa, për profilet e shkollave artistike dhe shkollës speciale përdoret edhe ndonjë formë tjetër e vlerësimit.
2. Nxënësit me talent të veçantë vlerësohen në mënyrë të kombinuar, me test dhe me ndonjë formë tjetër që është e përshtatshme për fushën e caktuar.

#### **Neni 11** **Kohëzgjatja e testimit**

Testimi i nxënësve zgjat prej 3 deri në 6 orë dhe mbahet brenda 1- 4 ditëve.

#### **Neni 12** **Fitimi i së drejtës për avancim**

Nxënësi fiton të drejtën për avancim, nëse në test ka arritje mbi 90 % për çdo lëndë ose fushë mësimore.

#### **Neni 13** **Shpallja e rezultateve**

1. Rezultatet e testit për avancim shpallen më së largu 3 ditë pas mbajtjes së testimit.
2. Nxënësi i pakënaqur ka të drejtë që në afat prej 3 ditësh prej ditës së shpalljes së rezultatit ta shikojë testin në prezencën e kryetarit të komisionit.

**Neni 14**  
**Formimi i Komisionit për avancim**

1. Vendimin për caktimin e Komisionit për avancim e merr Sekretari i Përgjithshëm i MASHT.
2. Anëtarët e përhershëm të komisionit i cakton Sekretari i Përgjithshëm, në përbërje:
  - 2.1. DVSM: 1 përfaqësues, kryetar komisioni;
  - 2.2. Administrata e arsimit parauniversitar: 1 përfaqësues, anëtar;
  - 2.3. Institucionet arsimore: 1 përfaqësues, anëtar.
3. Anëtarët e Komisionit vlerësues në lëndën/fushën përkatëse i cakton Komisioni i anëtarëve të përhershëm.
4. Anëtarët e përhershëm të komisionit kanë mandat 3 vjet.
5. Komisioni nxjerr rregullat e punës dhe vepron sipas tyre.
6. Komisioni cakton orarin, vendin dhe kohën e procesit të vlerësimit.
7. Komisioni në afatin prej 3 ditësh, nga dita e përfundimit të testimit për avancim, përgatit raportin me shkrim, të cilin ia dorëzon Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT-it.

**Neni 15**  
**Avancimi i nxënësve**

1. Vendimi për avancim të nxënësit shpallet nga MASHT, dhe evidentohet në ditar për klasën/shkallën/nivelin e avancuar me numër dhe datë të vendimit, si dhe në librin amë të nxënësit në shkollë.
2. Nxënësi i avancuar fiton të drejtën që të regjistrohet në klasën/shkallën /nivelin e arritur me anë të avancimit.

**Neni 16**  
**Vendimi për avancimin e nxënësit në arsimin e lartë**

Nxënësit e avancuar me talent të veçantë, prej arsimit të mesëm të lartë në arsimin e lartë mund të regjistrohen në drejtimin përkatës për të cilin është avancuar, pa iu nënshtruar testit të maturës, në të kundërtën nuk ka mundësi të regjistrohet në drejtime të tjera.

**Neni 17**  
**Kompensimi i komisionit**


Kompensimi material i komisionit për punën e kryer bëhet sipas ligjit në fuqi.

**Neni 18**  
**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet udhëzimi administrativ nr. 6/2009: Mundësia dhe procedurat e realizimit të procesit të avancimit të nxënësve.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi e udhëzimit administrativ**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

  
**Prof. dr. Ramë Buja**, ministër

